

VENDIM
Nr. 555, datë 29.9.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES, TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË E MINISTRISË SË MBROJTJES, SI DHE PËR TRAJTIMIN E MJEKËVE NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijojnë:

- a) Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 2, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:
 - i. kreu 1.2 zëvendësohet me kreun 1.2, me titull “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
 - ii. në kreun 1.4, pas emërimit “Zëvendësdrejtor” shtohet nënndarja, si më poshtë vijon:

	Drejtor drejtorie	1	2%		65.000		
--	-------------------	---	----	--	--------	--	--

- b) Në lidhjen nr. 2, të përmendur në pikën 3, kreu 2.2 shfuqizohet.

2. Efektet financiare, për vitin 2018, të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për këtë vit dhe të fillojnë:

- a) Për punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, nga momenti i transferimit të punonjësve në pozicionet e reja pas miratimit të strukturave dhe të organikave përkatëse;
 - b) Për parashikimet e tjera, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1 (kreu 1.2)
Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit
Shëndetësor

I. Në drejtorinë qendrore dhe në drejtoritë rajonale

EMËRTIMI		PAGA MUJORE					
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	nga ... deri ... lekë
1	Drejtor i përgjithshëm	1	2%		118.100		
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm. Drejtor drejtorie në drejtorinë qendrore.	1	2%		100.000		
3	Drejtor i drejtorisë rajonale.	1	2%		95.000		
4	Përgjegjës sektori në drejtorinë qendrore. Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale.	1	2%		80.700		
5	Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale.	1	2%		61.000		
6	Specialist (niveli i parë)	1 ose 2, ose 3	2%		49.000		
7	Specialist (niveli i dytë)	1 ose 2, ose 3	2%		38.000		

II. Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor

EMËRTIMI		PAGA MUJORE					
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	nga ... deri ... lekë
1	Titullar i njërive vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në qarqe	1	2%		90.800		
2	Titullar i njërive vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në bashki	1	2%		80.700		
3	Shef shërbimi	1	2%		64.000		
4	Përgjegjës sektori	1	2%		42.000		
5	Përgjegjës i shërbimeve të shëndetit mendor	1	2%		49.500	5.000	
6	Mjek/specialist në shërbimet e shëndetit publik	1	2%		42.000	7.000	
7	Mjek/stomatolog/farmacist/inxhinier	1	2%		42.000		
8	Mjek/psikolog/punonjës social që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor	1	2%		42.000	5.000	
9	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%		38.200		
10	Kryeinfermier/kryevaksinotor	1	2%		35.200		
11	Teknik specialitetesh shëndetësore	1 ose 2, ose 2, ose 3, ose 4	2%		31.000	1.100	

		ose 5					
12	Infermier në shërbimet e shëndetit mendor	1 ose 2, ose 2, ose 3, ose 4, ose 5	2%		31.000	5.000	
13	Infermier	1 ose 2, ose 2 ose 3, ose 4, ose 5	2%		31.000		